



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam Department of Economy, Development and Tourism

DATE /A:	08.07.2020
PËR/ZA/TO :	Z. Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	Z. Artan Asllani, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë për Kuvend

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

I nderuar!

Nr. i prot. 2223
Br. prot. Dt. 08.07.2020

Kuvendi komunal i Rahovecit në vitin 2001, konkretisht delegatët kanë nxjerrë vendim për themelimin e zonës ekonomike – parkut industrial në fshatin Opterushë (vendimi 01 nr.65 i datës:13.07.2001) , pastaj në vitin 2004 Kuvendi komunal merr vendim mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit mbi caktimin e zonës ekonomike-parkut industrial (vendimi 01nr.112 i datës 30.03.2004), me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi mbi caktimin e zonës ekonomike-parkut industrial 01 nr.65 i datës 13.07.2001 në nenin 1, me që rastë zonës ekonomike – parkut industrial në parcelën nr.346 z.k.Opterushë i zvogëlohet sipërfaqja për 1.00.00/ha pra nga 35.89.84/ha në 34.89.83/ha. Sipërfaqja prej 1.00.00 ha është destinuar për ndërtimin e fushës futbolistike në Opterushë dhe i'u është dhënë në menaxhim Drejtorisë për Kulturë,Rini dhe Sport. Komuna e Rahovecit vazhdimisht ka dërguar kërkesa në Qeverinë e Rep. së Kosovës për themelimin e zonës ekonomike-parkut industrial , por tek në vitin 2018 me vendim të Kryeministrit z.Ramush Haradinaj (vendimi nr.03/52 ,datë:22.06.2018) aprovohet kërkesa e K.K.Rahovecit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme "pasuri shtetërore e Kosovës ,K.K.Rahovec, shfrytëzuese Ekonomia Pyjore me nr të njësisë kadatsrale P-71510056-00346-0 për krijimin e zonës ekonomike-parkut industrial në fshatin opterushë.

Pas marrjes së vendimit nga Qeveria e Rep. së Kosovës për themelimin e zon.ekonomike-park.industrial K.K.Rahovec konkretisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-159 PËR ZONAT EKONOMIKE, UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MTI) NR. 01/2014 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË PARAQITJES SË KERKESËS PËR MARRJEN E PËLQIMIT, PROCEDIMIT TË SAJ DHE DHËNIEN E PËLQIMIT, MËNYRËN DHE PROCEDURAT PËR KONSULTIM PUBLIK, SI DHE PËRMBAJTJA E RIGJISTRIT TË ZONAVE EKONOMIKE dhe UDHËZIM ADMINISTRATIV (MTI) Nr. 02/2014 PËR PËRMBAJTJEN E STUDIMIT TË FIZIBILITETIT ka parashtruar kërkesa për paisjen me pëlqime nga Ministritë e linjës dhe institucionet tjera për licencim të zonës ekonomike-parkut industrial (Ministria e Bujqësisë,Pulltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minierale-KPMM-ja, Instituti arkeologjik i Kosovës – MKRS, Studimin e fizibilitetit , Pëlqimin elektro-energjetik nga KEDS-i), gjithashtu kemi organizuar debatin publik me banorët e fshatit Opterushë dhe fshatërave për rreth.

Projektet e hartuara për licencim të zonës-ekonomike-parkut industrial:

- Projekti Ideor i Zonës Ekonomike-Parkut industrial
- Projekti për trajtimin e ujërave të zeza
- Projekti për furnizim me ujë
- Plani Zhvillimor komunal
- Projekti për furnizim me energji elektrike-zgjidhje teknike, si dhe dokumentet plotësuese të kërkuara nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë -MTI-ja

-Pas kompletimit të të gjitha dokumenteve, pëlqimeve dhe projekteve, K.K.Rahovec e ka parashtruar kërkesën për licencim të Zonës Ekonomike-Parkut industrial në Ministrinë për Tregëti dhe Industri, kërkesa me nr. 235 të datës 22.01.2020, pas shqyrtimit të lëndës dhe kërkesës nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Ministri i Tregëtisë dhe Industrisë Z.Endrit Shala me Vendimin 01.Nr.Prot.410 të datës: 27.01.2020 jep Pëlqimin për themelimin e Zonës Ekonomike, respektivisht Parkut Industrial në fshatin Opterushë.

-Pas themelimit dhe licencimit të zonës ekonomike-parkut industrial K.K.Rahovecit ka parashtruar kërkesë në Ministrinë për Tregëti dhe Industri-MTI për mbështetje financiare për funksionalizimin e zonës ekonomike-parkut industrial por që nuk është miratur deri më tani. Komuna e Rahovecit në vitin 2018 ka investuar në rrafshimin dhe nivelizimin e një pjesë të zonës ekonomike në vlerë prej 4,360.00 € , ndërsa në vitin 2019 komuna e Rahovecit ka investuar në vlerë prej 68,460.00 €, investimet janë kryer në rrafshimin dhe rrethimin e një pjesë të zonës ekonomike - parkut industrial. Gjatë vitit 2020 do të hartohet projekti kryesor për zonën ekonomike-parkut industrial,për vitin 2020 presim mbështetjen financiare nga Qeveria e Rep. së Kosovës dhe Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë.

Me respekt!